

# Inspektori i Lartë i Drejtësisë

## BULETINI MUJOR

Nr.13

# Shkurt 2022

**2** VJET  
**INSPEKTORI  
I LARTË I DREJTËSISË**



**ILD**  
INSPEKTORI I LARTË  
I DREJTËSISË



## MESAZH I INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, Z. ARTUR METANI, NË 2 VJETORIN E KRIJIMIT TË INSTITUCIONIT

Data 1 Shkurt shënoi 2 vjetorin e krijimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Janë 2 vite me përpjekje të përditshme për ngritjen e një institucioni publik dhe standardeve burokratike demokratike të funksionimit të tij, për krijimin e praktikave më të mira të komunikimit, transparencës, aksesit të qytetarëve.

Njëherazi, kanë qenë 2 vite, edhe pse me mungesa burimesh njerëzore, me dinamikë në rritje të praktikave të trajtuara dhe të standardeve të inspektimit të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Procedimet disiplinore të kryera, trajtimi në rritje i ankesave të qytetarëve, transparenca e vendimmarrjes dhe jetës institucionale të ILD-së,

janë tashmë standarde të vendosura pune.

Për ILD-në, mbetet vizion i pandryshuar gjetja e një balance mes respektimit të pavarësisë së magjistratëve dhe interesit publik për administrimin e drejtësisë.







Kultura e pandëshkueshmërisë është një standard që nuk vendoset për një vit apo për 2 vite, por ditë pas dite, me krijimin e praktikave solide profesionale, të cilat synojnë zëvendësimin e saj me një kulturë të re, atë të integritetit profesional e moral të magjistratëve.

Tani është koha që brenda sistemit gjyqësor kultura e integritetit profesional e moral, të lerë pas interesat kundër drejtësisë.

*Nuk është e lehtë, por as e pamundur.*

## PROCEDIMI DISIPLINOR NË 2 VITE PUNE TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Në 2 vite punë, 1 Shkurt 2020 - 1 Shkurt 2022, janë kryer:

-  22 procedime disiplinore të dërguara në KLGJ e KLP nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, konkretisht 15 gjyqtarë dhe 7 prokurorë.
-  ILD ka paraqitur 12 kërkesa për masën disiplinore “shkarkim nga detyra” në të dy Këshillat. Nga këto janë pranuar 8 (5 gjyqtarë e 3 prokurorë); 2 janë mbyllur pa vendim nga KLGJ dhe 2 janë në proces në Këshilla.
-  ILD ka paraqitur 1 kërkesë për masën disiplinore “pezullim nga detyra”, që është pranuar.
-  ILD ka kërkuar 5 masa disiplinore “ulje page”. Nga këto 2 janë pranuar pjesërisht dhe 3 janë në proces.
-  ILD ka kërkuar 4 masa disiplinore “vërejtje publike”. Nga këto 1 është pranuar, 1 është rrëzuar dhe dy janë në proces.
-  Nga procedimet në proces, 4 janë të pezulluara nga KLGJ, në pritje të vendimit të KPA.

### SI KEMI ECUR ME ANKESAT KËTO DY VITE?

Prej fillimit të punës, zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka patur në vëmendje të posaçme trajtimin e stokut të dosjeve me ankesa ndaj gjyqtarëve e prokurorëve të trashëguar nga institucione të tjera. Ky fond i konsiderueshëm arkivor përbëhet nga ankesa të patrajuara, ankesa të trajtuara pjesërisht apo në faza fillestare të shqyrtimit të tyre, si dhe raste të hetuara pjesërisht apo të papërfunduara nga ana e organeve të mëparshme, si Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministria e Drejtësisë, Këshilli i

Lartë i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm, Këshilli i Lartë Gjyqësor, apo Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Procedurat e ndjekura nga organet e mëparshme për trajtimin e këtyre praktikave dokumentare, për shkak të kompetencave të kufizuara e të ndara ndërmjet organeve të ndryshme gjatë periudhës kalimtare, rezultojnë se janë zhvilluar në mënyrë jo të plotë dhe të pjesshme. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë po punon sipas një metodologjie, që ka prioritet, shmangien kulturës së pan-

dëshkueshmërisë, dhe harresës. Ankesat apo praktikat dokumentare, trajtohen sipas një radhe përparësie të bazuar në kritere si: data e dorëzimit, faza e trajtimit nga ana e organeve të mëparshme, tipologjia ose urgjenca e trajtimit të ankesës, respektimi i parimit të barazisë dhe objektivitetit, si dhe koha e nevojshme për shqyrtimin dhe vlerësimin e secilës praktikë dokumentare. Paralelisht u kushtohet vëmendje edhe denoncimeve që kanë ardhur pranë ILD prej 1 shkurtit 2020, kur është ngritur institucioni.



**A e dini se?**

**#2 vjet ILD**

**22 procedime disiplinore**  
15 gjyqtarë+7 prokurorë

**A e dini se?**

**#2 vjet ILD**

**1 Shkurt 2020 - 1 Shkurt 2022**

- **12 kërkesa për shkarkim nga detyra**  
8 pranuar  
2 mbyllur nga KLGJ pa vendim  
1 pezulluar (në pritje të KPA)  
1 në proces
- **1 kërkesë për pezullim**  
pranuar
- **5 kërkesa për ulje page**  
2 pranuar pjesërisht  
3 në proces (pezulluar në pritje të KPA)
- **4 kërkesa për vërejtje publike**  
1 pranuar  
1 rrëzuar  
2 në proces

- **4333 Ankesa të konfirmuara**
- **1554 Ankesa të trajtuara**
- **2779 Ankesa në proces trajtimi**
- **137 Ankesa në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar**
- **41 Hetime disiplinore**

### ANKESAT NË SHIFRA 1 SHKURT 2020 – 1 SHKURT 2022

- ⇒ **4333 Ankesa të konfirmuara**
- ⇒ **1554 Ankesa të trajtuara**
- ⇒ **2779 Ankesa në proces trajtimi**
- ⇒ **137 Ankesa në proces verifikimi**
- ⇒ **41 hetime disiplinore**

### LLOJET E MASAVE DISIPLINORE SIPAS LIGJIT NGA MË E LEHTA TEK MË E RËNDA

- ⇒ **Vërejtje konfidenciale;**
- ⇒ **Vërejtje publike;**
- ⇒ **Ulje e përkohshme e pagës;**
- ⇒ **Ulje në detyrë, nga një pozicion më i lartë në një më të ulët, ose nga një gjykatë/prokurori më e lartë, tek një më e ulët;**
- ⇒ **Pezullim nga detyra;**
- ⇒ **Shkarkim nga detyra.**

## ANKIMIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posaçëm ankese, i cili:

- ◆ mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- ◆ të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në [info@ild.al](mailto:info@ild.al)
- ◆ ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.
- ◆ mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.



Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD-së [www.ild.al](http://www.ild.al), në seksionin “Si prano-hen ankesat”.

***“Angazhimi kryesor i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ushtrimi i funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme dhe me integritet nëpërmjet një sistemi përgjegjshmërie dhe llogaridhënie.”***

## STATISTIKA

Gjatë muajit **Shkurt**, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **79 ankesa** të cilat janë paraqitur nga qytetarë dhe institucione.

*Konkretisht:*

**70 ankesa** janë depozituar nga qytetarët;


**9 ankesa** janë përcjellë nga institucione dhe organizata për kompetencë;

**28 telefonata** me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.

**9 takime** me ankues.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion, gjatë muajit Shkurt 2022.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.



## SHKURTI I ILD

### NË SHIFRA

- ⇒ **109 vendime** arkivimi, nga të cilat;
- ⇒ **78 vendime** pas shqyrtimit fillestar,
- ⇒ **10 vendime** arkivimi pas verifikimit (ILD),
- ⇒ **21 vendime** arkivimi pas verifikimit nga dosje të mbartura nga KLD;
- ⇒ **17 vendime** verifikimi;
- ⇒ **1 vendim** për fillim hetimi disiplinor;
- ⇒ **1 kërkesë për procedim** disiplinor drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP).



## SEKTORI I NDIHMËS JURIDIKE DHE ANKESAVE NË ILD

Komunikimi me qytetarët është pjesë e punës së përditshme të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues cdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.



## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË VIZITË PUNE NË RUMANI

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani nisi një vizitë pune në Bukuresht, me ftesë të z. Lucian Netejoru, shefi i Inspektoriatit Gjyqësor të Rumanisë, në kuadër të bashkëpunimit të nisur Nëntorin e kaluar me Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë.

Metani takoi ministrin e drejtësisë së Rumanisë z. Cătălin Predoiu, me të cilin bashkëbisedoi mbi ecurinë e reformës në drejtësi në Shqipëri, një sfidë e ngjashme për të dy vendet, pasi reforma në drejtësi ka qenë kusht i rëndësishëm për antarësimin e Rumanisë në Bashkimin Evropian 15 vite më parë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë vlerësoi rolin e Rumanisë në mbështetje të hapjes së negociatave për Shqipërinë, kur mbante presidencën e radhës së Bashkimit Evropian dhe u shpreh se ndihmesa e Rumanisë me eksperiencën e saj me reformën në drejtësi në kuadër të procesit të antarësimit në BE, do ishte e vyer për Shqipërinë.

Për çështje të reformës në drejtësi dhe eksperiencën rumune z. Metani ka biseduar në një takim edhe me kryetaren e komisionit për çështjet ligjore të Senatit rumun, znj. Laura-Iuliana Scânte.



## ILD DO SHKËMBEJË PRAKTIKA PUNE ME HOMOLOGËT RUMUNË NË INSPEKTIMIN DHE HETIMIN DISIPLINOR



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani nënshkroi sot një Memorandum Mirëkuptimi me kreun e Inspektoratit Gjyqësor të Rumanisë, z. Lucian Netejoru, lidhur me forcimin e bashkëpunimit në fushën e përmirësimit të dhënies së drejtësisë.

Të dy drejtuesit e lartë nënvizuan interesin e përbashkët për garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, garantimin e pavarësisë së sistemit të drejtësisë, garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe mbrojtjen e interesit publik, nisur nga misioni dhe parimet që udhëheqin veprimtarinë e institucioneve respektive.

Të pranishëm gjatë ceremonisë së nënshkrimit ishin ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Rumania, z. Ilir Tepelena dhe inspektorë e anëtarë të kabinetit të zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe të Inspektoratit Gjyqësor të Rumanisë.

Memorandumi mes Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë dhe Inspektoratit Gjyqësor të Republikës së Rumanisë

synon forcimin e marrëdhënieve ndër-institucionale dhe shkëmbimi i praktikave më të mira në lidhje me procedurat e verifikimit të ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore, fillimin e procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe për inspektimet institucionale dhe tematike.

Në përgjigje të interesit të agjencisë rumune të lajmeve AGERPRES, Inspektori i Lartë i drejtësisë Metani tha se kjo vizitë pune është për të mësuar nga rruga që vendi ka përshkruar dhe nga eksperiencia rumune në përpjekjet për të ndërtuar një sistem gjyqësor korrekt dhe të drejtë, si pjesë e detyrave për t'u bërë vend anëtar i BE-së, një sfidë e ngjashme edhe për Shqipërinë.

“Ky është një kontribut real nga Inspektoriati Gjyqësor rumun tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë së Shqipërisë për të shkëmbyer praktikat më të mira sa i takon hetimit dhe monitorimit të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe gjithashtu në shkëmbim eksperiencash, inspektorësh. Njerëz nga ILD do vijnë herë pas here të takohen e punojnë me inspektorët rumunë por edhe inspektorët rumunë do vijnë në Shqipëri. Do organizojmë

konferenca të përbashkëta, do publikojmë manuale të përbashkëta e materiale që janë të rëndësishme për punën e gjyqtarëve e prokurorëve në Rumani por edhe në Shqipëri.

Këto janë kontribute reale për përmirësimin e punës së dy inspektorateve dhe padyshim do ketë rezultate më të mira në punën e monitorimit të punës së gjyqtarëve e prokurorëve.” u shpreh z.Metani.



Ndërsa shefi i Inspektoriatit Gjyqësor të Rumanisë kujtoi se vitin e shkuar, së bashku me kolegë nga Franca, Italia dhe Portugalia, anëtarë të Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Gjyqësorit, i cili u themelua më 2017, me iniciativën e Rumanisë, kanë qenë në Shqipëri në kuadër të një vizite të organizuar nga Këshilli i Evropës.

“Në kuadër të kësaj vizite, e cila synonte të vlerësonte përbushjen e kushteve për anëtarësimin e Inspektoratit të Drejtësisë së Shqipërisë në rrjetin tonë, zbuluam, si unë, ashtu edhe kolegët nga vendet e tjera, realizimet dhe statusin aktual të jashtëzakonshëm të Inspektoratit të Drejtësisë në Shqipëri. Kuptuam se kemi shumë ngjashmëri mes legjislacioneve, por edhe në praktikë mes Zyrës së Inspektorit të Lartë për Drejtësinë dhe Inspektoratit të Gjyqësorit në Rumani dhe kjo, që në fillim, ndërtoi premiset e këtij bashkëpunimi të cilit sot po i vendosim gurin e themelit. Është e nevojshme, dhe të gjitha vendet e tjera ishin dakord, të bashkëpunojmë ngushtë me Inspektoratin e Drejtësisë në Shqipëri, në kuadër edhe të procesit të mbështetjes që i japim procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, u shpreh Lucian Netejoru.

Z.Metani dhe z.Neteroju nënvizuan se vizitat studimore dhe shkëmbimi i eksperiencës do të jenë mjetet kryesore për realizimin e këtij komunikimi që u formalizua me nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit mes dy inspektorateve të drejtësisë.

Gjatë paradites Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani zhvilloi një takim pune me kryetarin e Këshillit të Lartë të Magjistraturës gjykatësin Bogdan Mihai Mateescu.



---

## INTERVISTË E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË ARTUR METANI PËR AGJENCINË SHTETËRORE RUMUNE TË LAJMEVE AGERPRES

---

Inspektori i Lartë i Drejtësisë dha një intervistë për Agerpres në datën 8 Shkurt 2022 gjatë vizitës së zhvilluar në Rumani.

### INTERVISTA

#### **Si ju duket kjo vizitë në Rumani?**

Jam shumë i lumtur që po zhvilloj këtë vizitë punë në Rumani për dy arsye: së pari Rumania ka treguar gjithmonë një mbështetje të madhe për Shqipërinë, vecanërisht gjatë përpjekjeve të Shqipërisë për të shpallur pavarësinë në fillim të shekullit të kaluar. Rumania ka qenë një aktor i fortë, që i ka mbështetur këto përpjekje diplomatikisht, politikisht dhe ne e vlerësojmë shumë këtë rol dhe në Shqipëri kemi ndjeshmëri shumë pozitive ndaj popullit rumun.

Rumania ka ndërmarrë një reformë kaq të madhe në sistemin gjyqësor, në sektorin e drejtësisë. Edhe në Shqipëri kemi ndërmarrë një reformë po kaq të madhe dhe prandaj kjo vizitë në Rumani është për të nxënë nga mësimet që Rumania ka kaluar, pra mësimet e nxjerra, për të mësuar nga eksperiencia rumune, në përpjekjet e saj për të ndërtuar një sistem drejtësie korrekt e të drejtë.

#### **Si mendoni se kjo marrëveshje do përmirësojë punën tuaj?**

Marrëveshja e bashkëpunimit që nënshkruam është vetëm një nga aspektet e kësaj vizite. Jam takuar me përfaqësues të parlamentit, të Senatit, takova ministrin e drejtësisë dhe do doja të falen-



deroja për organizimin e kësaj vizite kaq efektive z. Netejoru (shefi i Inspektoratit Gjyqësor të Rumanisë), për t'u takuar me të gjithë aktorët, që janë të rëndësishëm në përpjekjet e Rumanisë për suksesin e reformës në drejtësi dhe në përpjekje për të patur shkëmbime pune e për të nxënë nga mësimet e marra nga Rumania, kjo edhe përmes nënshkrimit të këtij memorandumi mirëkuptimi.

Ky është një kontribut real nga Inspektoriati Gjyqësor rumun tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë së Shqipërisë për të shkëmbyer praktikat më të mira sa i takon hetimit dhe monitorimit të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe gjithashtu në shkëmbim eksperiencash, inspektorësh.

Njerëz nga ILD do vijnë herë pas here të takohen e punojnë me inspektorët rumunë por edhe inspektorët rumunë do vijnë në Shqipëri. Do organizojmë konferenca të përbashkëta, do publikojmë manuale të përbashkëta e materiale që janë të rëndësishme për punën e gjyqtarëve e prokurorëve në Rumani por edhe në Shqipëri. Këto janë kontribute reale për përmirësimin e punës së dy inspektorateve dhe padyshim do ketë rezultate më të mira në punën e monitorimit të punës së gjyqtarëve e prokurorëve.

[Kliko për të ndjekur intervistën e plotë.](#)





## INSPEKTORË TË ILD SHKËMBIM EKSPERIENCË ME HOMOLOGËT RUMUNË

Gjatë vizitës së punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Metani në Bukuresht, delegacioni që e shoqëron, inspektorë dhe anëtarë të kabinetit po zhvillojnë disa sesione shkëmbim eksperience me inspektorët gjyqarë e prokurorë rumunë në zyrat e Inspektoratit Gjyqësor të Republikës së Rumanisë.

Inspektimi tematik dhe hetimi disiplinor ndaj gjyqtarëve e prokurorëve, në të gjitha fazat e tij, praktikat më të mira të punës, legjislati përkatës dhe sfidat e këtij procesi ishin në fokus të komunikimit mes homologëve shqiptarë dhe rumunë.

Memorandumi i mirëkuptimit i nënshkruar gjatë kësaj vizite nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë Metani dhe homologu rumun Netejoru parashikon projekte të përbashkëta dhe vizita studimore dhe shkëmbim eksperience e informacioni lidhur me praktikat më të mira të punës për zhvillimin me sukses të aktivitetit të inspektorateve të drejtësisë në Shqipëri dhe Rumani.



## **INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ZHVILLON TAKIME PUNE NË INSTITUCIONET E DREJTËSISË NË RUMANI**

Në kuadër të vizitës së punës në Bukuresht, Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani ka zhvilluar një sërë takimesh në institucionet e drejtësisë së Rumanisë, për t'u njohur me eksperiencën rumune mbi reformën në drejtësi, si një zhvillim i ngjashëm në të dy vendet, që synon reformimin e sistemit gjyqësor dhe rritjen e luftës kundër korrupsionit, një proces i nisur herët në Rumani e i lidhur me anëtarësimin e saj në Bashkimin Evropian.

Në takimin me anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, gjykatësen znj. Mona-Maria Pivniceru, gjykatësin z. Cristian Deliorga dhe gjykatësin z. Gheorghe Stan, Inspektori i Lartë z. Metani diskutoi mbi ndryshimet e ardhura nga reforma në drejtësi si në Rumani ashtu edhe në Shqipëri, roli i inspektimit e hetimit disiplinor në dy vendet, si dhe praktika legislative kushtetuese vendase dhe europiane lidhur me masat disiplinore ndaj magistratëve.

Zbatimi i reformës në drejtësi në Rumani dhe roli i magistratëve në konfigurimin e ri ish-in në qendër të bashkëbisedimit të Inspektorit të Lartë z. Metani me kryetarin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, gjykatësin z. Bogdan Mihai Mateescu e më tej me drejtoreshën e Institutit Kombëtar të



Magjistraturës, gjykatësen znj. Cristina Rotaru-Radu.

Mbi reformën në drejtësi dhe efektet e saj në sistem e në shtetin e së drejtës z. Metani shkëmbeu mendime me kryetaren e komisionit për çështjet ligjore të Senatit rumun, znj. Laura-luliana Scânteï dhe kryetaren e komisionit për çështjet ligjore dhe imunitetet në Dhomën e Deputetëve, znj. Laura-Cătălina Vicol-Ciorbă.

Z. Metani zhvilloi një takim pune edhe me Prokuroren e Përgjithshme znj. Gabriela Scutea, ndërsa më herët takoi ministrin e drejtësisë z. Cătălin Predoiu.





## INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË TAKIM PUNE ME ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani zhvilloi një takim pune me drejtues të organizatave të shoqërisë civile, që monitorojnë zbatimin e reformës në drejtësi, për të hedhur hapa të një bashkëpunimi të vazhdueshëm për monitorimin e punës së zyrës së ILD-së, si dhe për dhënien e përvijës dhe mendimeve, lidhur me ecurinë e punës dhe sfidat e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në takim morën pjesë zj. Erida Skëndaj nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit; z. Afrim Krasniqi nga Instituti i Studimeve Politike; z. Ardian Dhima nga Instituti për Studime Politike dhe Ligjore; z. Ardian Hackaj nga Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim dhe zj. Ina Xhepa nga Qendra Europiane.



Në fjalën e vet Inspektori i Lartë i Drejtësisë vuri në dukje se i konsideron organizatat e shoqërisë civile, si një mekanizëm shumë i fortë monitorues i punës së institucioneve, e posaçërisht ILD-së, i testuar me marrjen e mendimeve në kuadër të hartimit të Planit Strategjik e Planit të Veprimit të punës së institucionit. Z. Metani tha se synon ta vijoje këtë përvijë përmes krijimit të një mekanizmi



**ILD**  
INSPEKTORI I LARTË  
I DREJTËSISË

---

## KLP NUK PRANON KËRKESËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR PROCEDIM DISIPLINOR NDAJ MAGJISTRATËVE F.G. DHE M.L.

---



Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk ka pranuar në A.R., janë mospërbushje e detyrës së mbledhjen e datës 24 Shkurt kërkesën e prokurorit, të cilit i është dhënë atributi Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për kushtetues për të ushtruar ndjekjen penale procedimin disiplinor ndaj magjistratëve F.G. dhe kontrolluar hetimet paraprake, me qëllim prokuror i Prokurorisë pranë Gjykatës së dërgimin e çështjes në gjykatë, në respektim të Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe M.L., për afateve ligjore procedurale penale. Sipas periudhën e ushtrimit të detyrës si prokuror raportit hetimor, prokurori M.L., pa shkaqe të drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së arsyeshme ka lejuar moszbatimin e Udhëzimit të Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Kryetari z. Gent Ibrahim i tha se Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi rrëzimin e propozimit të konfuzion për kohën e dorëzimit të akteve nga ILD-së për dhënien e masës disiplinore prokurori i çështjes dhe në vijim në të gjithë “vërejtje publike”, ndaj magjistratëve F.G. dhe zinxhirin e hallkës së funksionimit administrativ në Prokurori për kalimin e akteve në gjykatë.


Hetimi disiplinor i Inspektorit të Lartë të Sipas konkludimit të raportit hetimor të Drejtësisë ka filluar mbi bazën e informacionit Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, veprimet/ të paraqitur në media, lidhur me ngjarjen mosveprimet e ndërmarra nga ana e tragjike të datës 28.09.2021, ndodhur në magjistratëve F.G. dhe M.L., përbëjnë shkelje qytetin e Lezhës, ku si pasojë e veprimeve të disiplinore të lehtë, sipas nenit 102, pika 1, kryera nga shtetasi A.R, ka humbur jetën shkronja “l” e ligjit me nr. 96/2016 dhe bazuar oficeri i policisë S.H. në këtë dispozitë ILD i kërkoi KLP-së caktimin e

Në raportin e paraqitur para Këshillit të Lartë masës disiplinore “Vërejtje publike” për të dy të Prokurorisë, ILD konkludoi se veprimet e magjistratët, kërkesë që u rrëzua nga Këshilli i mosveprimet e F.G. në hetimin e shtetasit Lartë i Prokurorisë.

## Shkurt 2022

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë

© ILD



## KONTAKT ILD


WEB: [ild.al](http://ild.al)

EMAIL: [info@ild.al](mailto:info@ild.al)

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13  
Tiranë, Shqipëri



[Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani](#)  
[@ILD\\_Albania](#)

 [Inspektori i Lartë i Drejtësisë](#)



Spot prezantues ILD  
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë  
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)